

Dua të Adhuroj...

Mirë se erdhe në festimin e kishës sonë! Dua të ndaj një mesazh të veçantë... Shpesh flasim sesa na do Perëndia, dhe sot do të shikojmë se si ta duam ne Atë, duke u bazuar këtë në këtë varg:

Zbulesa 4:11b *'sepse ti (Perëndi) i krijove të gjitha gjërat, dhe nëpërmjet vullnetit tënd (për kënaqësinë tënde) ekzistojnë dhe u krijuan''.*

Sa bukur e thotë ky varg, që ne u krijuam dhe ekzistojmë për vullnetin e Tij, për t'i sjellë kënaqësi Perëndisë.

Për ne - ata që janë prindër: Sa nga ne kënaqemi kur shikojmë fëmijët tanë? Shumë herë. E njëjta gjë ndodh edhe me Perëndinë; Ai kenaqet shumicën e herëve kur na sheh ne.

Perëndia të krijoj për kënaqësinë e Tij. Kur ti linde, kur dole nga mitra e nënës tënde, Perëndia ishte aty, në dhomën e maternitetit, duke buzëqeshur, sepse erdhe ti në jetë, krijimi i Tij. Ai të solli në jetë për një arsye, një plan, një qëllim, një shkak.

Shpesh flasim sesa shumë na do Perëndia, dhe sot dua të shohim anën tjetër: Perëndia do që edhe ti ta duash Atë.

Një ditë, Jezusi po ecte rrugës dhe një djalë e pyeti, "Zot, cili është urdhërimi më i madh në gjithë Biblën?" Jezusi i bëri një përmbledhje të gjithë Biblës.

Mateu 22:37-38 *'Duaje Zotin, Perëndinë... Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi.'*

Perëndia thotë, "Unë të njoh dhe të dua. Dhe pres që ti të më njohësh mua dhe të më duash."

Fjala që e përmbledh këtë është një fjalë që është keqpërdorur shumë nga shumë njerëz. Është fjala **ADHURIM**.

Adhurim do të thotë ta njohësh dhe ta duash Perëndinë.

Kur ti dëgjon fjalën "adhurim," çfarë të vjen në mendje? Ndoshta lutja, këndimi, ardhja në festimet e kishës, ose kur bën diçka për kishën. Apo ndonjë veprim tjetër i tillë.

Por adhurimi është shumë më shumë se kaq.

1. Adhurimi është qëllimi primar në jetë.

Të duash dhe të adhurosh Perëndinë është bërë synim primar, prioritet i jetës nga Jezusi.

Si duket një person kur adhuron? A e ke menduar ndonjëherë?

A ngjan me një person me duart lart ose sytë nga qielli?

Ka shumë mënyra sesi adhurohet Perëndia. Vargu më i mirë për ta përkufizuar adhurimin do të ishte ky:

Romakeve 12:1. *“Nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer te Perëndia, që është shërbesa juaj e mënçur.*

(Ky është adhurimi i vërtetë që duhet t’i japim Perëndisë.)

Ja ku është pjesa, *“Paraqite trupin tënd, për t’i pëlqyer Perëndisë.”* Prit të ndaloj pak te ky varg.

Së pari, adhurimi është: **Reagimi im pasi kam përjetuar dashurinë e Perëndisë.** Adhurimi është mënyra se si reagoj dhe si i përgjigjem dashurisë që Perëndia ka për mua. Vargu fillon me dhembshurinë dhe mëshirën e Perëndisë. Në fillim, Ai pati dashuri dhe dhembshuri ndaj nesh, pastaj pritet që ne ta duam dhe ta adhurojmë Atë.

Pra, fillimisht Perëndia mori iniciativën. Perëndia është Ai që gjithmonë merr iniciativën. Ai bëri lëvizjen e parë kur të krijoi ty, pastaj kur të shpëtoi. Ai na jep faljen. Ai na bekon. Ai na mbron. Dhe për shkak të të gjitha këtyre gjërave që Ai ka bërë dhe bën për ne, ne e adhurojmë Atë. Vargu thotë se ne e ofrojmë veten tonë, e japim dhe e sjellim veten tonë para Tij; kjo fjalë përshkruan adhurimin.

Së dyti, adhurimi është: **T’i kthesh Perëndisë atë që ke marrë nga Ai.** Sa herë që jemi mirënjohës ndaj Perëndisë, kjo gjë i sjell kënaqësi Atij.

Tani, pyetja është në lidhje me fjalën “paraqiteni, ofroni.” Çfarë duhet të paraqes, të ofroj? Çfarë mund t’i japim një Perëndie që ka gjithçka? Ai krijoi botën dhe të krijoi ty. Ai bëri qiejt dhe galaksitë (jo Samsung Galaksi, por një galaksi shumë më të madhe). Çfarë mund t’i japësh një Perëndie të tillë? Jepi dashurinë tënde. Dhe Ai na jep detaje sesi t’ia japim këtë dashuri Atij.

Te **Marku 12:30** thuhet *“Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!”*

Ky vargu quhet ndryshe Urdhërimi i Madh.

Perëndia do që ta duam Atë në tri mënyra:

Së pari, ta duam me mendjen tonë. Vargu thotë, "**Duaje Perëndinë me gjithë mendjen tënde.**" Kjo do të thotë të dish me bindje logjike të plotë në kokën tënde se e do Atë. Njihe Perëndinë dhe duaje me gjithë mendjen tënde.

Së dyti, ta duam me pasion, "*me gjithë zemrën dhe me gjithë shpirtin.*" "Duamë me pasion", thotë Perëndia, "sepse edhe Unë të dua ty me pasion."

Së treti, ta duam praktikisht, "*me forcën tënde,*" me të gjitha aftësitë e tua.

Një gjë është e habitshme: megjithëse Perëndia ka krijuar të gjithë botën dhe të gjithë universin dhe të ka krijuar ty, janë tri gjëra që Perëndia nuk i ka nëse ti nuk ia jep Atij. Ouuu.

Ai nuk ka **vëmendjen tënde**, nëse ti nuk ia jep. Kjo është "Duaje Perëndinë me gjithë mendjen tënde."

Ai nuk ka **pasionin tënd**, nëse ti nuk ia jep. Kjo është "Duaje Perëndinë me gjithë zemër dhe shpirt."

Ai nuk ka **aftësitë e tua**, nëse ti nuk ia jep. Kjo është "Duaje me forcën tënde."

Këto na i ka dhënë Perëndia që në fillim: mendjen, shpirtin, zemrën dhe forcën. Adhurim quhet kur ne i marrim këto gjëra që na i ka dhënë Perëndia dhe ia kthejmë, ia japim Perëndisë përsëri. Le t'i shikojmë me ngadalë.

Adhurim është ta përqëndrosh vëmendjen te Perëndia.

Ta përqëndrosh mendjen, logjikën, dhe vëmendjen te Perëndia. Perëndia do që ti ta adhurosh atë me mendjen tënde.

Perëndia do vëmendjen tënde sepse Ai e ka vëmendjen te ti.

Te **Psalmi 139:1-3** "*Ti më ke hetuar, o Zot, dhe më njeh. Ti e di kur ulem dhe kur ngrihem, ti e kupton nga larg mendimin tim. Ti e shqyrton me kujdes ecjen time dhe pushimin tim (çdo gjë) dhe i njeh thellë të gjitha rrugët e mia.*"

Ti e shqyrton, e shikon me kujdes çdo gjë që bëj dhe kudo që shkoj. Çfarë do të thotë? Perëndia është i fokusuar tek ti gjatë gjithë kohës, nuk i ndan sytë nga ti asnjë sekond. E di pse? Sepse Ai të do. Ai të krijoi që të të japë kaq shumë vëmendje.

Një nga mënyrat për të kuptuar nëse dikush të do ose jo është vëmendja. Një djalë mund të thotë për një vajzë, "*Po, unë kam blerë për të iPhone-n e fundit, varëse, unaza, po bëhem copë me dy punë për të fituar para për dhurata të tjera dhe ajo më thotë që unë nuk e dua.*" Një vajzë që të do me të vërtetë nuk do

gjërat e tua, do vëmendjen tënde. Vëmendja është një nga mënyrat kryesore sesi shprehet dashuria.

Perëndia e ka vëmendjen gjithmonë tek ti.

Kush e mban mend kur ka rënë në dashuri për herë të parë?

Ndoshta kemi disa të vegjël, nën moshë, por mendoni kur ishit në kopësht.

Kush e mban mend atë ditë? Ai/ajo nuk të hiqej nga mendja. E mendoje sa zgjoheshe në mëngjes, gjithë ditën dhe deri kur shkoje të flije. Ka shumë mundësi që tani nuk je më i lidhur me atë të dashurin/ të dashurën e parë, sepse ke qenë shumë i vogël kur u dashurove për herë të parë... Dhe kur u rrite ndryshove mendim dhe u dashurove me dikë tjetër.

Por, krahasuar me këtë, dashuria e Perëndisë për ty nuk luhetet, nuk ndryshon, nuk mbaron; është e përjetshme.

Dhe Ai do që ta duash me të njëjtën vëmendje që të do Ai.

Por disa herë është e vështirë. Për ne është më e lehtë të largojmë vëmendjen nga diçka sesa të qëndrojmë të fokusuar. Ne nuk jemi si ato aparatet fotografike ose smartphone-t e fundit që, kur i drejton ndaj një objekti, fokusohen automatikisht. Ne duhet të zgjedhim vetë nëse do të qëndrojmë të fokusuar te diçka apo te dikush.

Po si ta bëjmë këtë? Çfarë na shpërqendron?

E para është vetja jonë; ne jemi shumë egoistë nga natyra. Nuk je vetëm ti; të gjithë janë kështu, ndoshta një më shumë, ndoshta një më pak. Fokusimi te vetja është e kundërta e fokusimit te Perëndia. Ai që është 100% i dhënë pas vetes e injoron Perëndinë dhe përfundimisht mendon më shumë për veten sesa për Perëndinë.

Pra, duhet të zgjedhim qëllimisht të ndalojmë së menduari për disa gjëra dhe të fillojmë të mendojmë për disa të tjera.

Si bëhet kjo?

Së pari, duke vendosur të kalosh kohë me Perëndinë çdo ditë. 15 minuta çdo ditë. Nuk ka rëndësi se kur e kalon këtë kohë – mund të jetë në mëngjes, në drekë, në pasdite, ose në mbrëmje – duke lexuar një kapitull të Biblës dhe duke u lutur.

Është një kohë që ti zgjedh qëllimisht për të ndaluar vrullin e ditës, apo trafikun në kokën tënde me 100 gjëra që të vijnë në mendje, dhe të lexosh Biblën dhe të bisedosh me Perëndinë. Ti zgjedh vetë qëllimisht të ndalosh dhe të mendosh për Perëndinë.

Ja si thotë Bibla, **Mateu 6:6** “*Por ti, kur lutesh, futu në dhomëzën tënde, mbylle derën dhe lutju Atit tënd në fshehtësi (thjeshtë dhe me sinqeritet); dhe Ati yt, që shikon në fshehtësi, do të ta shpërblejë publikisht.*”

Disa gjëra kyçe nga ky varg:

1. **Gjej një vend të qetë:** Futu në dhomën tënde të qetë, një vend ku ndihesh rehat dhe pa shpërqendrim. Ky vend mund të jetë në shtëpi, në punë, në ballkon, në një kafene të qetë, në dhomën e gjumit, në makinë... kudo që ti ndihesh rehat dhe i qetë.
2. **Lutja të jetë e thjeshtë dhe e sinqertë:** Ka njerëz që luten me fjalë të zgjedhura dhe të kujdesshme, por lutja jote nuk ka nevojë të jetë e tillë. Kur bisedon me shokët, flet me fjalë të thjeshta dhe të përditshme. Fol me Perëndinë siç do të flisje me një mik të ngushtë. Nuk ka nevojë të përdorësh fjalë të bukura për ta impresionuar; Perëndia të njeh dhe di çfarë ke në zemër.
3. **Mbaj biseda të vazhdueshme me Perëndinë:** Kjo nënkupton që të kesh një komunikim të vazhdueshëm dhe të sinqertë me Perëndinë. Përpiqu të bisedosh me të shpesh dhe të ndihesh të lidhur me të gjatë gjithë ditës.

Psalmet 105:4 *'Kërkoni Zotin dhe forcën e tij; kërkoni vazhdimisht fytyrën e tij.'*

Sa më shumë dhe sa më shpesh të fokusohesh te Perëndia, aq më shumë do të përfitosh në jetën tënde.

Te **Isaia 26:3** “*Mendjes që pushon te ti, ti i ruan një paqe të përsosur, sepse kjo ka besim te ti (është e fokusuar tek Ti).*”

Kur e fokuson vëmendjen tënde tek vetja, fillon të shqetësohesh, të kesh pasiguri, ankth, faj, frikë dhe zhgënjim. Por kur e përqëndron vëmendjen tek Perëndia, fillon të ndiesh mirënjohje, shpresë, qetësi, besim dhe dashuri. *Adhurimi është kur e nis ditën duke fokusuar vëmendjen tënde te Perëndia...*

2. Adhurimi është kur shpreh pëlqimin tënd ndaj Perëndisë.

Kjo është kur ti e do Perëndinë me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt. Ndoshta për disa kjo mund të jetë e vështirë, sepse mund të jesh rritur në një familje ku nuk janë thënë shumë fjalë vlerësuese. Nëse nuk ke marrë shumë komplimente ose nuk të janë thënë shpesh nga prindërit ose nga vëllezërit e motrat sa i mirë je, mund të të jetë e vështirë të shprehësh pëlqimin.

Por, mund të mësosh gradualisht të shprehësh dashurinë dhe pelqimin tënd ndaj Perëndisë.

Kur i ke thënë për herë të parë "Të dua" një personi? Ka mundësi që të kesh qenë i frikësuar për vdekje. (shembull: Unë kisha aq frikë t'ia thosha asaj vajzës që e doja, sa që ia shkrova në një letër dhe ika. Më pas, kisha turp kur do e takoja.) Kur ka qenë për ty hera e parë që i ke thënë dikujt "Të dua"? Si ndiheshe? A ishe nervoz? A të përzihej? A të djersitshin duart? A ishte bërë stomaku yt sa një dardhë?

E di pse ndodh gjithë kjo furtunë emocionale? Sepse nuk e di si do të reagojë ai/ajo. Do ta pranojë dashurinë tënde apo do ta marrë keq?

Për ta lehtësuar situatën, a e mban mend kur ishe në shkollë të mesme dhe i dërgove një person tjetër për t'i thënë një vajze se ti e kishe fiksuar? U sigurove njëherë për përgjigjen që do merrje po t'i thoshë vetë. Kur more informacion pozitiv, ooo, ti u përveshe për propozimin serioz, "Të dua... ti je kështu, ti je ashtu...", me të gjitha frutat e pyllit: rrush, fik, mollë, qershi.

Por e bukura është se Perëndia e ka hequr rrezikun; Ai e ka thënë i pari që të do. Perëndia ka shprehur dashurinë e Tij ndaj teje në shumë mënyra. Prandaj, nuk është e sikletshme t'i thuash Perëndisë edhe ti, "Të Dua!"

1 Gjonit 4:19 *"Ne e duam atë, sepse ai na deshi i pari."*

A i ke thënë Perëndisë, "**Perëndi, edhe unë të dua!**"? Perëndia do që ta dëgjojë këtë deklaratë dashurie nga ti. Le të shprehim së bashku dashurinë tonë ndaj Perëndisë dhe ta themi bashkë: "Perëndi, edhe unë të dua!"

Disa mund të thonë: "Si ka mundësi që Perëndia më do mua, apo e ka vëmendjen tek unë, sepse Perëndia duhet të jetë shumë i zënë. Ku ka kohë Ai të merret me mua? Ai ka mundësi të mos ma dijë as emrin mes 7.8 miliard njerëzve në botë." Por Perëndia e di, Ai të njeh, është i përfshirë në çdo detaj të jetës tënde. Ai të do aq shumë dhe dëshiron që ti t'ia kthesh dashurinë Atij gjithashtu. Nuk është kurrë i zënë; Ai gjen gjithmonë kohë për ty.

Eksodi 34:14b *Nuk do t'i përulesh një perëndie tjetër sepse Zoti, emri i të cilit është "Xheloz", është një Perëndi xheloz.*

Xheloz, këtu ka kuptimin të të dojë me shumë pasion. Ai dëshiron me shumë pasion të ketë miqësi me ty.

Si do të ishte nëse një ditë të bukur do të shkoja te gruaja ime me një dhuratë dhe t'i thosha: "Zemra, kjo është për ty. Po ta jap këtë dhuratë për tre arsye: 1.

Sepse unë jam burri yt. 2. Kemi përvjetorin e martesës sot. 3. Sepse të gjithë burrat e martuar kështu bëjnë në përvjetore martesash. Kështu që merre.”

A do të gëzohej ajo me këtë lloj qëndrimi? Nuk mendoj. Pse? Ajo do që unë ta dua me pasion, jo si diçka që e kam për detyrë.

Perëndia nuk dëshiron që ti ta duash vetëm sepse duhet bërë, sepse kështu bëjnë të krishterët, ose sepse është thjesht një detyrë.

“Ooo po, po, edhe unë e dua Zotin. Po po, Zotin duhet ta adhurosh nga pak. Zot, të dua pra, kaq gjë e kupton ti, Zoti para unë mbrapa.”

Ai dëshiron miqësi dhe marrëdhënie pasionante me ty. Ai thotë: *“Unë dëshiroj që ti të më duash ashtu siç të dua unë ty, sepse unë të kam krijuar, unë të kam bërë.”*

Fillo duke thënë “faleminderit.” Fillo të falenderosh Zotin për gjërat që ke rreth teje. “Faleminderit, o Zot, për këtë ditë, për këtë diell, për familjen, për punën, shkollën, lidhjen, për fejuaren, gruan, burrin, fëmijët, për shtëpinë, këtë dhe atë...” Gjej gjëra rreth e rrotull për t’i thënë faleminderit Perëndisë. “Faleminderit që jam mirë me shëndet, që...”

Ky është një fillim i lehtë për të shprehur mirënjohje dhe dashuri ndaj Krijuesit, Perëndisë tënd.

Nëse çdo njeri do të kuptonte sesa shumë e do Perëndia dhe sa shumë kujdeset Ai për çdo detaj të jetës së tyre, do të pushonin një sekondë për ta falenderuar.

Adhurim është kur e shpreh me fjalë dashurinë që ke ndaj Perëndisë: Ne e duam atë sepse Ai na deshi i pari.

3. Adhurimi është kur përdor aftësitë e mia për Perëndinë

Kjo është ta duash Perëndinë me gjithë forcën tënde.

Dashuria nuk ka nevojë vetëm për fjalë të bukura dhe puthje. Ka dhe një lloj tjetër dashurie, një dashuri praktike.

Në rastin e të martuarve, ka disa punë shtëpie që duhen bërë. Ka disa gjëra që duhet të rregullohen në shtëpi. Ka disa blerje që duhet të bëhen. Ka disa përgjegjësi që nuk mund të injorohen, ka disa fëmijë që duhet të kujdesen të dy.

Çiftet e martuar e tregojnë dashurinë duke ndihmuar në gjërat që duhen bërë për familje. Kur martohesh, kupton se dashuria nuk shprehet vetëm me fjalë të bukura, por ka edhe një anë praktike.

Cilës grua mund t'i thuash vetëm me fjalë: “Të dua shumë, zemra, por nuk bëj dot punë, nuk laj dot enët, nuk hedh dot qesen e mbeturinave, nuk i marr dot fëmijët, lodhem të shkoj të marr qumështin, bukën në market. A punon vetëm ti, ndërsa unë të rri në shtëpi?!” Çfarë do të thoshte gruaja jote? Do të thoshte: “Lëri llafet e bukura, ma trego me vepra se sa më do.”

E njëjta gjë ndodh me adhurimin. Ne adhurojmë kur bëjmë gjëra praktike në emër të Perëndisë.

Kolosianeve 3:23 “*Cdo gjë që të bëni, ta bëni me dëshirë të mirë, si për Zotin dhe jo për njerëzit*”.

Nëse do të zbatojmë këtë varg 100%, do të ndodhin gjëra të pabesueshme. Thotë: “Çdo gjë që bëni—çfarë kuptimi ka, thjesht çdo gjë që bëni, bëje si për Zotin dhe jo për njerëzit.”

Ky është adhurimi nga ana praktike: çdo gjë bëje për lavdinë e Perëndisë. Kjo do të thotë, kur je në punë, ta bësh atë punën sikur Perëndia është shefi yt dhe po e bën për Të. Kur lan enët, bëje sikur po i lan enët e Perëndisë; kur bësh çdo gjë, bëje sikur po e bën për Perëndinë.

Kjo është ta ftosh Perëndinë në çdo zonë të jetës tënde. Në jetë nuk ka rëndësi se çfarë bën, por për kë e bën?! Bëje çdo gjë si për Perëndinë. Dhe me këtë lloj qëndrimi, puna jote, çdo gjë që bën ti, kthehet në adhurim.

Pastaj, nuk ka rëndësi nëse je kuzhinier, kamarier, polic, mekanik, bankier, punonjës i pastrimit, student, apo çfarëdo lloj pune. Ti mund të bësh çdo gjë si për Perëndinë, duke thënë: “Do ta bëj këtë punë sikur po e bëja për Perëndinë.” Mund të punosh në një lavazh, mund të jesh infermier, mund të bësh punë shtëpie, mund të jesh shofer apo menaxher. Nuk ka rëndësi lloji i punës, për sa kohë që e di për kë e bën atë punë.

Disa luten: “Zot, çfarë të bëj në jetë, këtë punë apo atë punë?” Perëndia do të thoshte: “Nuk ka rëndësi. Nuk ka rëndësi lloji i punës, por për kë e bën atë punë.”

Të kesh një qëndrim të tillë: “Perëndi, do të jem turni i parë në lokal këtë javë, por do ta bëj atë punë sikur po e bëja për Ty. Perëndi, do të jem gjithë javës duke bërë statistika dhe duke dërguar emaile pa fund, por do i bëj sikur po i bëja për Ty. Zot, do të jem në shkollë gjithë javës, por do përqëndrohem në mësim dhe do të mësoj sikur po mësoja për Ty.”

Ky lloj qëndrimi do ta kthejë punën, shkollën, çdo gjë që bën në adhurim 24 orë në ditë për Perëndinë. Ai do gjithë jetën tënde, do që ta adhurosh me gjithë jetën tënde.

Kush është gati për këtë lloj qëndrimi që nesër?

“Perëndi, që nesër kur të kthehem në punë, e di që është ajo punë që ka më shumë gjëra që më bezdisin sesa që më gëzojnë, apo do të shkoj në shkollë dhe nesër kam mësim me atë profesorin që e di vetë se kush është, por nesër do të shkoj me një qëndrim ndryshe. Do të shkoj me një pronar të ri. Sepse nesër do të bëj çdo gjë për Ty.”

Ky lloj qëndrimi do ta kthejë situatën e zakonshme në një kuptim të ri, në adhurim ndaj Perëndisë. Dhe gradualisht e gjithë jeta jote do të kthehet në një stil jete adhurimi ndaj Perëndisë.

Çdo njeri adhuron diçka. Ti je krijuar për të adhuruar Perëndinë. Ai e ka vendosur këtë dëshirë brenda teje. Ti nuk mund të rish pa adhuruar diçka apo dikë. Mund të shkosh në çdo kulturë dhe do të gësh njerëz që adhurojnë diçka. Nëse njeriu nuk adhuron Perëndinë, besomëni, do ta zëvendësojë shumë shpejt me dikë ose diçka tjetër.

Po ti vetë, çfarë po adhuron? Është ajo gjë që i jep më shumë vëmendje, më shumë kënaqësi dhe pas së cilës po punon më shumë. Tundimi më i madh në jetë është nxitja për të adhuruar diçka tjetër përveç Perëndisë.

Gabimi më i madh në jetë mund të jetë të mos dish cili është qëllimi kryesor i saj. Kuptohet lehtë nëse i bën vetes pyetjen se për çfarë mendon më shumë, sepse atë që ti mendon më shumë, atë e do më shumë. Nëse bën një përmbledhje se ku e kalon pjesën më të madhe të kohës së lirë dhe ku i shpenzon më shumë paratë, këto tregojnë se çfarë është ajo që do ti më shumë.

Bibla thotë: "Ti je krijuar për kënaqësinë e Perëndisë." Ti u bërë për ta njohur dhe dashur Perëndinë. Kështu që të nxis të vendosësh atë si Nr.1 në jetën tënde para çdo gjëje tjetër dhe çdo ditë.

Pali tha: “Prandaj përpiqemi t’i pëlqejmë Atij...” (2 Korintasve 5:9). Nuk ka qëllim më të mirë dhe më të lartë se sa ky, të pëlqehesh nga Perëndia, të sjellësh kënaqësi për Perëndinë. Ky është adhurimi.

Le të lutemi.